



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2660 prot.

Fushë-Arrëz, më 2.09.2025

VENDIM

Nr. 32, datë 27.08.2025

“PËR

**MIRATIMIN E PLANIT VENDOR PËR BARAZINË GJINORE 2025-2027 PËR
BASHKINË FUSHË-ARRËZ”**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; Ligjit nr.9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", Vendimit nr. 400, datë 30.6.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021-2030, dhe të planit të saj të veprimit". Ligjit Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit Nr. 125/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006 " Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar; Ligjit Nr. 124/2020 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10221/04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar. Ligjit Nr. 35/2020 "Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Ligjit Nr. 136/2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjit Nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara"; Ligjit Nr.104/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 101/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji Nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligji Nr. 65/2016 "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë", Ligji Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijes", Ligji Nr. 37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur", Ligji Nr. 111/2017 Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” i ndryshuar, Ligji Nr. 35/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7905, datë 21.03.1995. "Kodi i Procedures Penale", i ndryshuar, Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin”, Ligji Nr. 22/2018 “Për strehimin social” i ndryshuar, Ligji Nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit" i ndryshuar, Ligji Nr. 75/2019 "Për rininë" i ndryshuar; Relacionit të hartuar nga Sektori për Çështjet Sociale me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, **Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës 27.08.2025**, pasi shqyrtoi materialin e hartuar nga grupi i punës dhe dëgjoi shpjegimet e specialistëve të fushës përkatëse,

VENDOSI

1. Të miratojë Planin Vendor për Barazinë Gjinore 2025-2027 për Bashkinë Fushë-Arrëz, sipas Planit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Migracionit, Diasporës, Projekteve Sociale si dhe sektorët e tjerë ndërveprues.

3. Ky vendim u zbardh me datë **2.09.2025** dhe hy në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike sipas pikës 6, neni 55 të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

Vendimi u miratua nga Këshilli Bashkiak Fushë-Arrëz me:


9 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

SEKRETAR

Naze SELIMAJ



KRYETAR

Nikolin BARDHOKU

